



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 620 Akti

Nr. 379 Vendimi
Tiranë, më 30.4.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bektashi Kryesuese
Lulzim Hamitaj Relator
Etleda Çiftja Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 29.4.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Genti Dokollari, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, aktualisht i komanduar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Genti Dokollari, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë¹, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 29.4.2021, kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- i. Z. Genti Dokollari ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016 në: Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); si dhe pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim KLGJ).
- ii. Pika 4 e nenit 179/b, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: *“Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë [...] do të rivlerësohen, ex officio”*. Në këto kushte, dhe duke konsideruar kandidimin e subjektit për emërim në gjykatën e apelit, ka filluar me përparësi procedura e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Genti Dokollari.
- iii. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” (në vijim Komisioni), ky i fundit ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga i cili rezultoi se për subjektin e rivlerësimit, z. Genti Dokollari, procesi i rivlerësimit do të kryhej nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Lulzim Hamitaj dhe Etleda Çiftja.
- iv. Trupi gjykues i sipërpërmendur, pasi administroi dhe analizoi të tria raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me vendimin nr. 1, në datën 21.12.2020, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktohej kryesuese e trupit gjykues komisionere Brunilda Bekteshi. Gjithashtu, në këtë mbledhje anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
- v. Trupi gjykues, pas përfundimit të fazës hetimore mbi rivlerësimin e subjektit Genti Dokollari, me vendimin nr. 2, datë 16.4.2021, vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ky ligj.
- vi. Në datën 26.4.2021 Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: rezultatet e hetimit kryesisht – duke e ftuar për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të

¹ Aktualisht i komanduar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

kundërtën – për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke i dhënë kohë për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegimet.

- vii. Ndonëse nuk u njoh me dosjen përkatëse, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit kryesisht, përpara afatit të caktuar nga Komisioni.
- viii. Në datën 26.4.2021, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë, përmes postës elektronike, subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore të caktuar në datën 29.4.2021, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Genti Dokollari, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, si dhe me pjesëmarrjen e subjektit të rivlerësimit.
- ii. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, z. Genti Dokollari ka parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.
- iii. Seanca dëgjimore e datës 29.4.2021, u mbyll, për të rifilluar më 30.4.2021, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë hetimit administrativ.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLGJ-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; si dhe (ix) faktet e njohura botërisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-JA

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Genti Dokollari, duke konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

A/2. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

1. Apartament me sip. 54.4 m², në zotërim, në Korçë

1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* zotërimin pa kundërshpërblim të apartamentit me sip. 54.4 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me adresë: Lagjja nr. ***, rr. "N. K.", p. ***, Korçë, në bashkëpronësi të shtetasve Sh. K. dhe S. K..
2. Për të provuar zotërimin dhe përdorimin e pasurisë, subjekti vuri në dispozicion deklaratën e datës 25.1.2017, të shtetasit M. K., në të cilën deklarohet se apartamenti është në pronësi të xhaxhait të tij, i cili prej disa vitesh nuk jeton në Shqipëri dhe ka dhënë pëlqimin për dhënien në përdorim të apartamentit subjektit të rivlerësimit.
3. Përgjatë hetimit administrativ, ASHK-ja Korçë, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 23.4.2019, dhe shkresës nr. *** prot., datë 8.1.2021, ka bërë me dije se apartamenti me të dhënat kadastrale të sipërcituara figuron i regjistruar në emër të bashkëpronarëve Sh. K. dhe S. K.. Kjo pasuri rezulton të jetë përfutur me kontratën e privatizimit të datës 11.5.1993, të nënshkruar nga z. Sh. K. dhe Ndërmarrja Komunale e Banesave, kundrejt çmimit 3,771 lekë.
4. Subjekti, pasi është pyetur nga Komisioni për të qartësuar mbi përdorimin e apartamentit, nëpërmjet pyetësorit nr. 2 ka bërë me dije se ka qëndruar në këtë apartament nga muaji

maj i vitit 2016 deri në qershor të vitit 2018², si dhe ka paraqitur një deklaratë të datës 19.2.2021, të lëshuar nga të dy bashkëpronarët, të cilët kanë deklaruar se subjekti ka qëndruar në banesën e tyre, me dijeninë dhe pëlqimin e tyre, pa paguar qira.

5. Lidhur me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm të interesit, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me shkresën nr. *** prot., datë 22.12.2020, e cila, me shkresën nr. *** prot., datë 5.1.2021, ka bërë me dije se për shtetasin Sh. K. janë dhënë disa vendime gjyqësore të cilat i përkasin një periudhe më të hershme krahasuar me fillimin e ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit.
6. Më tej, subjekti i rivlerësimit ka pohuar se pas transferimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë ka banuar fillimisht në një apartament të ndodhur në rr. "F. M.", në pronësi të hallës së tij, znj. S. K. dhe bashkëshortit të saj, z. Q. K., dhe nuk ka paguar qira. Gjithashtu, ka shpjeguar se pas kthimit nga emigracioni të bashkëshortit të vajzës së hallës ka banuar përkohësisht në një apartament tjetër, po në pronësi të hallës, sërish pa qira.
7. Për të vërtetuar pronësinë e apartamenteve të sipërcituara, së bashku me përgjigjet e pyetësorëve nr. 1 dhe nr. 2, subjekti ka vënë në dispozicion dokumentacionin ligjor të pasurive të paluajtshme, si: certifikatën e pronësisë së apartamentit në rr. "F. M."; kontratën e shitblerjes; si dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme të apartamentit të dytë – pasuri këto në pronësi të hallës dhe bashkëshortit të saj.
8. Gjithashtu, nga kontrolli *online* i kryer nga Komisioni në sistemin multifunksional të ZRPP-së nuk ka rezultuar ndonjë pasuri e paluajtshme e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Genti Dokollari.
9. Nisur nga sa është përshkruar dhe analizuar më sipër, trupi gjykues nuk ka konstatuar problematika lidhur me përdorimin e pasurive në fjalë, pa kundërshpërblim, nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe i konsideron bindëse shpjegimet e tij.

2. Apartament me sip. 96.8 m², në zotërim, në F., Tiranë

10. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar zotërimin pa kundërshpërblim të apartamentit me sip. 96.8 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, të ndodhur në Njësinë Administrative F., rr. "C.", në pronësi të prindërve të tij. Ka rezultuar se ky apartament është përfitur me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 7.1.2008, të lidhur ndërmjet shoqërisë së ndërtimit "****" sh.p.k.³ dhe z. S. D., babai i subjektit të rivlerësimit – kundrejt çmimit 55,000 euro.
11. Për të provuar zotërimin dhe përdorimin e apartamentit në fjalë, bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një deklaratë të datës 25.1.2017, të babait të tij, në të cilën ky i fundit ka deklaruar se apartamenti është i regjistruar në emër të tij dhe si burim krijimi kanë shërbyer kursimet e tij dhe të bashkëshortes ndër vite, duke shtuar se, meqenëse subjekti është djali i tyre i vetëm, ai ka banuar në këtë apartament prej vitit 2008, kur ka qenë student, dhe në vijim.

² Kur është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

³ Përfaqësuar nga z. T. Ç. dhe z. F. K..

12. Përgjatë hetimit administrativ, lidhur me verifikimet e kryera për këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:
- i. ASHK-ja⁴ Tirana Rurale 1, me shkresën nr. *** prot., datë 28.1.2021, ka konfirmuar se në emër të shtetasit S. D. figuron e regjistruar pasuria e llojit “apartament”, me sip. 96.8 m², me nr. ***, z. k. ***, me vendndodhje S., Tiranë.
 - ii. Gjithashtu, FSHU-ja, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 30.12.2020, ka bërë me dije se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të nuk rezulton të ketë kontratë furnizimi me energji elektrike.
 - iii. UKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 8.1.2021, ka bërë me dije se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe nënës së tij nuk rezulton ndonjë e dhënë për kontrata për shërbime me këtë institucion. Ndërsa, për babain e subjektit, z. S. D., ka konfirmuar ekzistencën e një kontratë me nr. ***, të lidhur për objektin e lartpërmendur, në F., Tiranë.
13. Nga sa më sipër, trupi gjykues, duke konsideruar se apartamenti në fjalë është blerë mbi 5 vjet më herët nga emërimi i subjektit të rivlerësimit si gjyqtar dhe duke pasur në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimin nr. 7/2020, çmon se nuk kanë rezultuar arsye të mjaftueshme për kryerjen e hetimeve/verifikimeve lidhur me burimet financiare të krijimit të pasurisë në fjalë nga prindërit e subjektit, vetëm për faktin se ky apartament është përdorur nga ky i fundit.

3. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa ***

14. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, me nr. shasie ***, në DIPP-të e viteve 2013⁵ dhe 2014 dhe më pas në deklaratën *Vetting*. Ka rezultuar se ky automjet është përfutur me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 31.1.2014, të nënshkruar midis palës shitëse, shoqëria “****” sh.p.k., të përfaqësuar nga administratorja Sh. S. dhe palës blerëse, subjekti i rivlerësimit, në vlerën 840,000 lekë.
15. Në vijim të hetimit administrativ, Komisionit i ka rezultuar se automjeti në fjalë është blerë fillimisht nga shtetasi O. S. në shtetin gjerman, nëpërmjet faturës nr. ***, datë 29.9.2010, kundrejt çmimit total 21,400 euro, së bashku me eksportin. Ky automjet, pasi ishte blerë në vlerën 840,000 lekë dhe ishte përdorur për një periudhë rreth 4-vjeçare nga subjekti i rivlerësimit, është shitur me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 28.3.2018, kundrejt çmimit 8,000 euro⁶.
16. Lidhur me blerjen e automjetit me një çmim më të ulët dhe shitjes së tij me një çmim më të lartë se ai i blerjes, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, e ka ftuar subjektin të japë

⁴ ASHK-ja Kolonjë, me shkresën nr. *** prot., datë 8.2.2021, ka bërë me dije se në emër të prindërve të subjektit të rivlerësimit në L., Kolonjë, figurojnë të regjistruara pasuritë, si vijon: (i) apartament banimi me sip. 58.88 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, në bashkëpronësi të shtetasve S. dhe Dh. D., e privatizuar me kontratën për privatizimin e banesës, datë 28.8.1993; (ii) njësi shërbimi me sip. 398 m² (në kartelë sipërfaqja është shënuar 39 m²), me nr. pasurie ***, z. k. ***, në pronësi të znj. Dh. D., privatizuar me kontratën e shitjes, datë 17.10.1992; si dhe (iii) godinë me sip. 17.6 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, në pronësi të z. S. D., përfutur fillimisht trualli me sip. 17.6 m², me kontratën për shitjen e truallit, datë 11.10.1999, dhe më pas ndërtuar objekti 1-katësh me lejen e ndërtimit të miratuar me vendim nr. ***, datë 25.8.1999, të KRRT-së.

⁵ DIPP-ja e vitit 2013 përpara fillimit të detyrës.

⁶ Në të cilën subjekti ka qenë i përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. ***, datë 12.1.2018, nga shtetasi Z. O.. Subjekti ka shpjeguar në pyetësorit nr. 2 se shtetasi Z. O. është një mik i tij, i cili është edhe mekanik dhe ka pasur mundësinë për të ekspozuar automjetin dhe t'u përgjigjej blerësve potencialë.

shpjegime, i cili ka bërë me dije se çmimi i blerjes prej tij në shumën 840,000 lekë nuk ka qenë çmimi i tregut të automjetit, por një çmim preferencial⁷ për shkak të shoqërisë disavjeçare që kishte me shtetasin O. S.⁸, si dhe për shkak të gjendjes së automjetit që kërkonte kryerjen e shpenzimeve të nevojshme për riparim/mirëmbajtje. Po ashtu, subjekti ka shpjeguar se shkak për të cilin çmimi i shitjes së automjetit në fjalë nga ana e tij ka qenë më i lartë se çmimi me të cilin e kishte blerë, lidhet me faktin se çmimi i blerjes ka qenë një okazion dhe se ka kryer shpenzime të tjera për mirëmbajtje⁹.

17. Nga sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar se blerja e automjetit nga subjekti me një çmim më të ulët duket si trajtim preferencial dhe, si i tillë, duhet të ishte deklaruar në rubrikën e të dhënave konfidenciale/dhurata dhe trajtime preferenciale në DIPP-në e vitit 2014.
18. Lidhur me ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit me palën shitëse të automjetit në analizë, nga përgjigjet e ardhura nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁰ dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë¹¹ nuk ka rezultuar ndonjë çështje gjyqësore e gjykuar nga subjekti i rivlerësimit për shoqërinë “***” sh.p.k. apo me shtetasit O. S. dhe Sh. S., ose me shoqërinë “***” sh.p.k. Po ashtu, Komisioni i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë mbi çështje të mundshme të gjykuara me palë ndërgjyqëse shtetasin R. K., blerësi i automjetit në fjalë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me shkresën nr. *** prot., datë 10.3.2021, ka bërë me dije se në emër të shtetasit R. K. ka pasur vetëm dy çështje, të cilat nuk janë gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, z. Genti Dokollari.
19. Përgjatë hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin, si vijon:
 - i. DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 31.12.2020, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka aktualisht në pronësi automjetin me targa ***, si dhe ka pasur në pronësi automjetet me targa *** dhe me targa ***, duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin përkatës.
 - ii. Kontratë kredie bankare hipotekore nr. ***, datë 27.1.2014, lidhur midis subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e kredimarrësit, prindërve të tij, në cilësinë e hipotekuesve dhe “Raiffeisen Bank”, në cilësinë e kredidhënësit, për marrjen e kredisë konsumatore në shumën totale 2,109,418 lekë.
 - iii. Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 31.1.2014, e lidhur midis palës shitëse, shoqëria “***” sh.p.k.

⁷ Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur edhe dy kontrata të dy automjeteve të tjera të blera nga pala shitëse O. S., një automjet “Mercedes-Benz ***”, në datën 8.11.2012, dhe një automjet “Mercedes-Benz” të blerë në janar të vitit 2014.

⁸ Subjekti ka bërë me dije se shtetasi O. S. është i biri i B. S. dhe Sh. S., të cilët janë përkatësisht ortaku dhe administratori i shoqërisë “***” sh.p.k.

⁹ Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet të pyetësorit nr. 2, ka bërë me dije se pas blerjes së automjetit ka kryer shpenzime servisi për automjetin, në total në shumën rreth 220,000 – 240,000 lekë, shpenzime këto të kryera *cash*. Po ashtu, pak muaj pas blerjes, në gusht/shtator të vitit 2014, ka kryer një shpenzim prej 163,081 lekësh për rregullimin e automjetit, sipas faturës nr. ***, datë 11.9.2014, të lëshuar nga servisi “***”. Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2021, i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë informacion mbi çështje të mundshme të gjykuara me palë ndërgjyqëse shoqërinë “***” sh.p.k. Në përgjigje të sa më sipër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka bërë me dije se nuk ka rezultuar ndonjë çështje civile themeli e gjykuar për këtë palë.

¹⁰ Informacion i ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 5.2.2021.

¹¹ Informacion i ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 22.12.2020.

- iv. Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 28.3.2018, e lidhur midis palës shitëse Genti Dokollari dhe palës blerëse R. K..
- v. Gjithashtu, AMF-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 30.12.2020, ka konfirmuar kontratën e sigurimit për automjetin në fjalë.
- vi. Ministria e Drejtësisë, RNSH, me shkresën nr. *** prot., datë 5.1.2021, ka konfirmuar ekzistencën/lidhjen e kontratave të shitblerjes së automjetit në analizë.

3.1. Lidhur me analizimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie, ka rezultuar si vijon:

- 20. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie në DIPP-në e vitit 2013, si dhe në deklaratën *Vetting* kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank”, për garantimin e të cilës është vendosur si kolateral apartamenti i sipërtrajtuar – në pronësi të prindërve, në F., Tiranë.
- 21. “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 8.1.2021, ka konfirmuar se subjekti ka përfituar një kredi në shumën 2,109,418 lekë, të marrë në datën 29.1.2014, dhe të likuiduar/mbyllur¹² më 23.7.2019, duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin përkatës.
- 22. Nga verifikimet e kryera, në lëvizjet e llogarive bankare të subjektit, është konfirmuar disbursimi i kredisë në datën 29.1.2014 dhe transferimi i shumës prej 840,500 lekësh në favor të shoqërisë shitëse “****” sh.p.k., në datën 30.1.2014, ndërkohë që pjesa tjetër e kredisë prej 1,224,750 lekësh¹³ është tërhequr nga subjekti i rivlerësimit në *cash*.
- 23. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, e ka ftuar subjektin e rivlerësimit për të bërë me dije mbi destinacionin e përdorimit të shumës së mbetur, si dhe mbi mosdeklarimin prej tij në DIPP-në e vitit 2014 të ndonjë shpenzimi të kryer, investimi apo kursimi nga shuma e kredisë. Në përgjigje të sa i është kërkuar, subjekti ka bërë me dije se, ndonëse në kontratën e kredisë në “Raiffeisen Bank” është përcaktuar në cilësinë e kredimarrësit të vetëm, kredia në fjalë është marrë së bashku me prindërit e tij, të cilët kishin rënë dakord që nga shuma totale do të përdorej prej subjektit të rivlerësimit vetëm pjesa e nevojshme për blerjen dhe rregullimet e automjetit në analizë, ndërsa pjesa tjetër do të merrej nga prindërit për shpenzimet e kryera për mobilimin e apartamentit në F., Tiranë.
- 24. Referuar shpjegimeve të dhëna lidhur me pyetësin nr. 2, subjekti ka bërë me dije se prindërit kishin shpenzuar paraprakisht përgjatë periudhës shtator 2013 – janar 2014 shumën 600,000 lekë për mobilimin e apartamentit në Tiranë, nga kursimet e tyre. Ndërkohë që pas marrjes së kredisë në “Raiffeisen Bank” ka deklaruar se nga shuma totale e kredisë ka marrë përfaqësisht 1,100,000 lekë (për blerjen e automjetit dhe rregullimet e tij) dhe diferencën e mbetur prej rreth 1,000,000 lekësh e kanë marrë prindërit për mobilimin e apartamentit në Tiranë.
- 25. Nisur nga përmbajtja e përgjigjeve të subjektit, sipas të cilave prindërit janë kompensuar prej tij për shpenzimet e kryera, nëpërmjet kredisë bankare, ndonëse kjo e fundit ka vazhduar të shlyhet vetëm me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit – në këto kushte, shuma

¹² Kredia rezulton të jetë shlyer e gjitha nga subjekti i rivlerësimit.

¹³ Pas zbritjes së shpenzimeve të komisionit të disbursimit, pagesave për sigurimin e jetës dhe të pronës së vendosur kolateral, si dhe të vlerësimit të pasurisë, të cilat kanë rezultuar në shumën totale 44,168 lekë.

e mbetur e kredisë prej 1,000,000 lekësh është konsideruar, në analizën financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, si shpenzim i kryer nga subjekti i rivlerësimit.

26. Pasi janë analizuar dhe vlerësuar të gjitha të dhënat e administruara deri në momentin e mbylljes së hetimit administrativ, subjektit i janë njoftuar rezultatet si vijon:
- i. Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në rubrikën e të dhënave konfidenciale dhurata dhe trajtime preferenciale në DIPP-në e vitit 2014, blerjen e automjetit me një çmim preferencial.
 - ii. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me marrëdhënien me shitësin e automjetit dhe shkaqet e trajtimit preferencial, si dhe mbi shumat e pretenduara si të shpenzuara për mirëmbajtjen e automjetit në fjalë, nuk duken bindëse.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

27. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e sipërpërshkruara – për të cilat i ishin kërkuar shpjegime – përveç dokumentacionit që ka depozituar së bashku me prapësimet, si dhe përgjatë seancës dëgjimore, ndër të tjera, është shprehur se: *“[...] sa i përket marrëdhënies me shtetasin O. S. kam miqësi të hershme që prej vitit 2009, kemi ndjekur gëzimet familjare te njëri-tjetrit, kemi kaluar pushime dhe festa së bashku. Për të provuar këtë miqësi po ju paraqes si provë fotografi ndër vite, ‘check-in’, apo fotografi nga rrjeti social facebook, të cilat janë bërë para dhe pas vitit 2014. Lidhur me çmimin e automjetit ka qenë ‘...për mik, duke përlllogaritur amortizimin e mjetit, gjendjen e tij dhe njëkohësisht shpenzimet e nevojshme xhenerike, goma dhe pjesë të tjera konsumi, që kishte nevojë, të cilat i kam kryer unë pas blerjes. [...] Lidhur me diferencën e çmimit të blerjes së automjetit prej tij dhe çmimin tim të blerjes, e sqaroj se nuk jemi përpara një çmimi jo real, apo çmimi jo të drejtë të tij, pasi së pari, po ju vë në dispozicion një kontratë shitjeje të njëjtës lloj makinë në periudhë të përafërt kontratë shitblerje automjeti tip ‘Mercedes-Benz CLS ***’, kundrejt çmimit 990,000 lekë; së dyti, makina ka qenë vit prodhimi 2006, pra, në momentin e blerjes ka qenë 8 vjet makinë; së treti, është përdorur për katër vjet në Shqipëri nga viti 2010 - 2014, duke përshkruar nga 140.000 km kur ka ardhur nga Gjermania, në 220.000 km, kur e kam blerë unë; së katërti, O. ka pasur tre makina në pronësi në momentin që unë ia kam blerë. [...] Keni të drejtë në lidhje me faktin që nuk kam paraqitur prova në lidhje me shpenzimet e kryera, por së pari, kam vlerësuar se shpjegimet kanë qenë bindëse; dhe se dyti, nuk kam pasur prova përveçse faturës së muajit shtator 2014, në shumën 163,081 lekë. Në lidhje me shpenzimin për goma dhe konvergjenca, sqaroj se vendi ku i kam blerë gomat ka qenë në unazë dhe nuk ekziston më [...] Në lidhje me subjektet ku kam kryer shërbimet, nga verifikimi pranë ‘***’, nuk rezultonte dokumentacion, apo faturat përkatëse për atë periudhë, ndërsa tek një subjekt tjetër më bëri me dije se nuk ishte regjistruar në organet tatimore”.*

Vlerësimi i trupit gjykues

28. Lidhur me diferencën e konstatuar midis çmimit të blerjes dhe të shitjes së automjetit, nisur nga shpjegimet e subjektit dhe pas analizimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe të administruar nga Komisioni – sipas të cilave diferenca e çmimit të lartpërmendur të blerjes me çmimin e shitjes së automjetit vijnë si pasojë e marrëdhënies miqësore

disavjeçare – trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit janë deri diku bindëse, ndonëse nuk justifikojnë të gjithë diferencën në fjalë. Megjithatë, duke pasur në vëmendje shpenzimet e kryera dhe ato të pretenduara si të tilla, por të paprovuara me dokumentacion mbështetës – edhe për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, si dhe duke konsideruar edhe dinamikën e tregut të lirë – për sa kohë nuk ka rezultuar ndonjë konflikt interesi apo element tjetër që mund të lidhej me funksionin e subjektit të rivlerësimit dhe palën blerëse apo shitëse, trupi gjykues nuk e çmon këtë rrethanë si një shkak të mjaftueshëm në vetvete për të passjellë pasoja për subjektin e rivlerësimit. Ndërsa, lidhur me mosdeklarimin e trajtimit preferencial në deklaratat përkatëse, trupi gjykues, në përfundim vlerëson se kjo rrethanë përbën një pasaktësi në deklaram, por e parë edhe në harmoni me rezultatet e tjera, në tërësinë e çështjes, si dhe në raport me parimin e proporcionalitetit, çmohet se kjo pasaktësi nuk mund të mjaftojë për të aplikuar ndonjë masë për subjektin e rivlerësimit.

4. Gjendje *cash* në shumën 100,000 lekë, e deklaruar në deklaratën *Vetting*

29. Në DIPP-në e vitit 2014 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e automjetit tip “Volkswagen Golf”, kundrejt çmimit 2,500 euro, por nuk e ka deklaruar këtë vlerë si të disponuar *cash* në fund të vitit.
30. Ndërkohë, nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2015 ka rezultuar se subjekti ka deklaruar pakësimin e pasurisë së krijuar nga shitja e automjetit tip “Volkswagen Golf” në shtator të vitit 2014, në vlerën 2,500 euro, pakësuar me 1,500 euro, të shpenzuara për nevoja të zakonshme, si dhe gjendje të mbetur *cash* prej 1,000 euro.
31. Më pas, në DIPP-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar pakësimin me 90,000 lekë dhe disponimin në fund të vitit të gjendjes *cash* prej 50,000 lekësh, si dhe në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si gjendje *cash* në shumën 100,000 lekë, me burim krijimi nga të ardhurat nga shitja e automjetit të sipërpërmendur.
32. Nisur nga sa më sipër, Njësia e Shërbimit Ligjor ka kryer analizën financiare për të evidentuar mundësinë e subjektit për të zëvendësuar shumën prej 50,000 lekësh në formën e kursimeve *cash*, nga data 1.1.2017 deri në datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, 26.1.2017.
33. Nga verifikimi i lëvizjeve bankare të subjektit të rivlerësimit është konstatuar se përgjatë periudhës së sipërcituar janë kryer tërheqjet *cash* në shumën totale 53,000 lekë. Pas zbritjes së shpenzimeve të jetesës në analizën financiare për të njëjtën periudhë, në masën 16,638 lekë¹⁴ dhe shpenzimeve për 3 udhëtime¹⁵ në masën 25,260 lekë, ka rezultuar se subjekti mund të kursente me burime të ligjshme financiare vetëm shumën prej 11,102 lekësh. Për rrjedhojë, duket se subjekti ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të realizuar kursimin prej 50,000 lekësh, si gjendje *cash*, në masën -38,898 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

34. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatin e sipërpërshkruar, përveç të tjerash, ka shpjeguar se: “[...] Gjetja dhe konstatimi juaj është absolutisht i drejtë, por kam një

¹⁴ Referuar Anketës së Buxhetit të Familjes për vitin 2017, publikuar në faqen zyrtare www.instat.gov.al.

¹⁵ Sipas deklaramit të subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 1, këto udhëtime të datave 12.1.2017, 19.1.2017 dhe 25.1.2017 kanë qenë me destinacion Strugën, për të furnizuar automjetin me karburant.

*shpjegim shumë real për këtë gjetje, sqaroj se deklaratën Vetting e kam dorëzuar më 26.1.2017, dhe shuma cash që disponoja në shtëpi nga verifikimi i bërë ka qenë 100,000 lekë. Ndërkohë, deklarata periodike e pasurisë është depozituar në datën 24.3.2017, pra dy muaj më pas. [...] Shpjegoj se në datën 7.3.2017 kam pasur 30 vjetorin e lindjes dhe kam vendosur të bëj një festë, duke mbledhur miqtë e mi më të afërt, pas bisedës me pronaren e lokal ‘***’ në total shuma shkonte 105,000 lekë. Kjo shumë është përballuar prej meje dhe prej prindërve si dhuratë për 30 vjetor, më saktësisht rreth 65,000 lekë prej meje dhe 50,000 lekë prej prindërve. [...] Në datën 24.3.2017, kur kam plotësuar deklaratën, në vend që të deklaroja 100,000 lekë sa kisha gjendje cash në fund të vitit 2016, i jam referuar deklaratës Vetting dhe kam deklaruar sa kam pasur gjendje cash në atë moment që ishte shuma prej 50,000 lekësh, pasi 50,000 lekë i kisha shpenzuar për ditëlindje. Sqaroj me sinqeritetin maksimal se kjo ka qenë e vërteta”.*

35. Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të shpjegimeve të tij, ka paraqitur në cilësinë e provave të reja: (i) foto të datëlindjes së tij; (ii) deklaratë të pronares/administratores së hotel “D.”; si dhe (iii) dokumentin e lëvizjeve të llogarisë së tij bankare për vitin 2017.

Vlerësimi i trupit gjykues

Trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë shpjegimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, vlerëson se ato rezultojnë bindëse, për sa kohë është sqaruar dinamika e lëvizjes, ruajtjes dhe shpenzimit të të ardhurave dhe, për rrjedhojë, nuk konstatohen më problematika lidhur me burimin e krijimit të mjeteve monetare që kanë mundësuar krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, ndonëse përgjatë hetimit administrativ dukej se kishte një pamundësi minimale, që gjithsesi, në frymën e parimit të proporcionalitetit, edhe nëse do të konfirmohej, nuk do të mund të passillte pasoja.

5. Lidhur me shumat e dhuruara nga prindërit dhe transfertat e tjera bankare

36. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si dhuratë nga prindërit e tij shumën prej 459,000 lekësh – të transferuara nëpërmjet disa veprimeve bankare të kryera nga prindërit dhe persona të tretë (të cilësuar prej tij si të afërm apo kolegë pune të babait). Nga shqyrtimi dhe analizimi i deklarimeve në DIPP-të ndër vite, ka rezultuar se subjekti ka deklaruar përkatësisht dhuratat e përfutuara nga prindërit në shumat 160,000 lekë në vitin 2014, 194,000 lekë në vitin 2015 dhe 120,000 lekë në vitin 2016, të cilat arrijnë në shumën 474,000 lekë.
37. Ndërkohë, nga verifikimi i kryer përgjatë hetimit mbi lëvizjet në llogaritë bankare të subjektit, që nga momenti i fillimit të detyrës dhe deri në dorëzim të deklaratës *Vetting*, janë konstatuar disa derdhje *cash* nga prindërit dhe nga persona të tretë, përkatësisht në shumat 649,000 lekë dhe 350,000 lekë, për të cilat Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar shpjegime subjektit.
38. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka bërë me dije se nga këto shuma, dy nga transfertat bankare të kryera nga babai në datat 12.3.2014 dhe 8.6.2015, përkatësisht në shumat

310,000 lekë dhe 200,000 lekë¹⁶, nuk kanë qenë për llogari të tij, por për banesën dhe aktivitetin tregtar të nënës. Ndërsa, nga derdhjet e kryera nga persona të tretë, shuma prej 30,000 lekësh¹⁷ nuk ka qenë e ardhur e dërguar nga prindërit, por hua, e cila nuk është përfshirë në deklarinimin e mësipërm, pas zbritjes së të cilave ka rezultuar shuma prej 459,000 lekësh, e deklaruar prej subjektit.

39. Po ashtu, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, për të paraqitur dokumentacionin ligjor që të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve për shumat e dhuruara, subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 dokumentacionin e mëposhtëm:
- i. vërtetim nr. *** prot., datë 1.8.2011, për vjetërsinë në shërbim dhe pagën mesatare referuese për shtetasin S. D., për periudhën gusht 2000 – nëntor 2006;
 - ii. vërtetim nr. *** prot., datë 11.10.2009, nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrë, për trajtimin me pagesë kalimtare për periudhën nëntor 2006 – qershor 2009;
 - iii. vërtetim nr. *** prot., datë 22.2.2021, nga DRSSH-ja Korçë për të ardhurat e përfituara nga shtetasi S. D. nga pensioni i parakohshëm, për periudhën korrik 2009 – mars 2015;
 - iv. vërtetim nr. *** prot., datë 22.2.2021, nga Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Gjirokastrë për të ardhurat e përfituara nga paga, për periudhën mars 2015 – dhjetor 2017, nga shtetasi S. D.;
 - v. vërtetim nr. *** prot., datë 19.2.2021, nga Agjencia Lokale e Sigurimeve Shoqërore Kolonjë, për sigurimin e nënës së subjektit, znj. Dh. D., pranë aktivitetit të saj Person Fizik, për periudhën janar 1993 – dhjetor 2011;
 - vi. vërtetim nr. *** prot., datë 19.2.2021, nga DRSSH-ja Korçë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të paguara për periudhën 2012 e në vijim nga shtetasi S. dhe Dh. D.;
 - vii. vërtetim nr. *** prot., datë 19.2.2021, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë për të ardhurat/fitimet e realizuara nga “Dh. D.”, Person Fizik, për vitet 2014 e në vijim.
40. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni, ka rezultuar se aktiviteti i nënës së subjektit, “Dh. D.”, Person Fizik, është regjistruar për zhvillimin e aktivitetit privat “tregti me pakicë të artikujve të ndryshëm”, në datën 1.1.2003¹⁸ me NIPT ***, në L., Korçë.
41. Bashkia Kolonjë, Njësia Administrative L., me shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2017, ka bërë me dije se për këtë aktivitet nuk disponohen të dhëna mbi fitimin e realizuar ndër vite, por disponohen vetëm deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor për vitet 2008 – 2013¹⁹. Gjithashtu, me anë të kësaj shkrese Bashkia Kolonjë ka bërë me dije se ky aktivitet ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore ndër vite.

¹⁶ Nga kjo shumë, subjekti është shprehur se vetëm 30,000 lekë kanë qenë për të dhe diferenca për llogari të babait. Nga shqyrtimi i llogarive bankare të babait të subjektit është konstatuar se shuma prej 200,000 lekësh rrjedh nga një kredi e marrë nga ky i fundit në “Raiffeisen Bank”.

¹⁷ Shuma këto të derdhura nga miqtë e tij A. V., prej 25,000 lekësh në datën 31.12.2013 dhe nga A. B. prej 5,000 lekësh, më 8.1.2014.

¹⁸ Ndonëse në certifikatën e regjistrimit në organin tatimor rezulton se znj. Dh. D. është regjistruar me vendim të nr. ***, datë 24.1.1992, të gjykatës.

¹⁹ Deklaratat kanë qenë përkatësisht në shumat 2,400,000 lekë, 2,000,000 lekë, 2,000,000 lekë, 1,800,000 lekë, 1,800,000 lekë dhe 1,800,000 lekë.

42. Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, me shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2017, ka bërë me dije se aktiviteti “Dh. D.”, Person Fizik, ka deklaruar si subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2014 – 2016 dhe nuk ka detyrime tatimore të papaguara.
43. Në vijim të sa më sipër, deri në fazën e mbylljes së hetimeve, pretendimet e subjektit lidhur me dhurimin e përfituar nga prindërit e tij vetëm për shumën 474,000 lekë, mbeten vetëm në nivel deklarativ dhe të pambështetura në dokumentacion provues. Për rrjedhojë, Komisioni ka përllogaritur në analizën e kryer të gjitha shumat e transferuara nga prindërit e subjektit dhe personat e tretë në llogarinë tij, si dhe të ardhurat e dokumentuara të prindërve dhe shpenzimet e tyre të jetesës, për periudhën 2013 – 2016, të detajuara në tabelën si vijon:

Viti	Paga e babait	Aktiviteti ne nes	Kredi	Shpenzime jetike	Mundësia perkursim	Dhurimet sipas deklaramëve	Mungesa e burimeve te ligjshme	Transferuar nepermjet bankes	Mungesa e burimeve te ligjshme
2013	169 158			282 048	- 112 890			10 000	- 10 000
2014	172 356	250 000		439 996	- 17 640	160 000	- 160 000	470 000	- 470 000
2015	534 034	300 000	200 000	448 552	585 482	194 000	-	404 000	-
2016	615 400	143 991		470 184	289 207	120 000	-	85 000	-
Totali	1 321 790	693 991	200 000	1 358 732	744 159	474 000	- 160 000	969 000	- 480 000

44. Lidhur me shumën totale prej 350,000 lekësh, të derdhur në llogarinë e tij nga persona të tretë, pasi është pyetur nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se dy prej tyre janë kushërinj të tij dhe të tjerët janë miq dhe kolegë pune të babait, nëpërmjet të cilëve janë dërguar paratë, për arsye se në L. nuk ka degë të bankave të nivelit të dytë.
45. Për të gjithë shtetasit që kanë kryer veprime bankare për llogari të babait të subjektit dhe në favor të subjektit, Komisioni i ka kërkuar informacion Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) mbi regjistrimin e mundshëm të ndonjë procedimi penal, mosfillimi apo pushimi në ngarkim të tyre. SPAK-u, me shkresën nr. *** prot., datë 17.3.2021, ka bërë me dije se nuk rezulton që në emër të shtetasve të përmendur në shkresë të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.
46. Pasi janë analizuar dhe vlerësuar të gjitha të dhënat e administruara deri në momentin e mbylljes së hetimit administrativ dhe nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit janë përllogaritur burimet financiare dhe shpenzimet e prindërve, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës dhe i janë njoftuar rezultatet e mëposhtme, nga ku bazuar në dokumentacionin dhe transfertat bankare të kryera në favor të tij prej prindërve dhe nëpërmjet personave të tretë, për shumën totale prej 969,000 lekësh, prindërit e tij kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -480,000 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

47. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, ka paraqitur prapësimet, argumentimet dhe prova të reja, të cilat përshkruhen në mënyrë të përmbledhur dhe analizohen, si vijon: “[...] Së pari, në analizën financiare në lidhje me burimet e prindërve, Ju i jeni referuar vetëm të ardhurave në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi të ardhurat, por keni harruar shumën prej

1,000,000 lekësh të kredisë së marrë në janar të vitit 2014, për të cilën kam dhënë shpjegime. Në analizën tuaj keni njohur shumën prej 1,000,000 lekësh si shpenzim të deklaruar prej meje dhe nuk ka asnjë arsye që ta përjashtoni nga të ardhurat e prindërve...

Së dyti, është logjikisht e papranueshme që prindërit e mi, të cilët kishin punuar 30 vjet deri në vitin 2014, kanë jetuar vetëm me të ardhurat që kanë nxjerrë atë vit dhe nuk kanë pasur asnjë kursim për të përballuar një hall apo kryer furnizimet e biznesit, kur ka prova konkrete që nëna ime ka pasur aktivitet tregtar nga viti 1992 dhe vijon aktualisht aktivitetin pa ndërprerje dhe ka qenë korrekte me detyrimet ndaj shtetit dhe dokumentacionin, fakt ky i konfirmuar edhe nga organet tatimore sipas informacionit të kërkuar prej jush.

Së treti, ju vë në dispozicion prova që provojnë ato që unë kam pretenduar se në fund të vitit 2013 dhe deri në janar të vitit 2014 prindërit kanë kryer shpenzime për mobilimin e shtëpisë në shumën rreth 600,000 lekë. Meqenëse në vitin 2013 Ju i keni nxjerrë prindërit në pamundësi financiare për të më dërguar mua 10,000 lekë, për shkak se nëna nuk ka deklaruar të ardhura, kur ndërkohë keni konfirmimin nga tatimet se ka shlyer detyrimet tatimore për të ardhurat nga biznesi i vogël, po ju vënë dispozicion një llogari bankare të babait në 'Raiffeisen Bank', nga e cila rezulton se babai ka pasur një depozitë në shumën rreth 818,000 lekë deri në vitin 2013. Në datën 28.5.2013 ka pasur gjendje në llogari 702,183 lekë dhe këto, nga sa më shpjegon babai, janë tërhequr. Sipas shpjegimit të prindërve këto kanë qenë gjendje, përveç parave cash në shtëpi që shërbenin për aktivitetin tregtar dhe me to janë kryer shpenzimet për mobilimin e shtëpisë deri në janar të vitit 2014 dhe për të kompensuar gjendjen në shtëpi iu kam dhënë mbrapsht edhe shumën prej 1,000,000 lekësh nga kredia e marrë.

*Së katërti dhe së pesti, për të pasur të qartë sjelljen e tyre karshi meje si fëmijë i vetëm [...]; të ardhurat e dërguara nga prindërit, të cilat kanë qenë konstante që prej vitit 2007, në vitet 2013 dhe 2014 [...] Së gjashti, në lidhje me personat që m'i kanë kaluar shumat në llogarinë bankare, po ju vë në dispozicion vërtetimin nr. *** prot., datë 20.4.2021, të Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit, Qarku Gjirokastrë, nga i cili rezulton se: '... shtetasit kanë qenë punonjës policie në Stacionin e Policisë Kufitare, Ç..*

Së shtati, nuk besoj se nevojat për jetesë të prindërve të mi që kanë jetuar dhe jetojnë në L., kanë shtëpi dhe dyqan në pronësi, janë 439,000 lekë për vitin 2014, 448,552 lekë për vitin 2015 dhe 470,000 lekë për vitin 2016”.

48. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur, në cilësinë e provës, dokumentacionin si vijon:

- i. vërtetim nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit të Qarkut Gjirokastrë;
- ii. kthim përgjigje nr. *** prot., datë 22.4.2021, nga Drejtoria Tatimore Korçë; si dhe
- iii. vërtetim nr. *** prot., datë 26.4.2021, nga Fakulteti i Drejtësisë.

Vlerësimi i trupit gjykues

49. Nisur nga konstatimi i rrethanave faktike të rezultuara nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, trupi gjykues, lidhur me përdorimin e shumës së mbetur të kredisë prej 1,000,000 lekësh – ndonëse është pohuar si kalim në favor të prindërve – vlerëson se në mungesë të provave ajo duhet të konsiderohet si një

shpenzim i kryer nga subjekti i rivlerësimit. Ky konkluzion rrjedh nga fakti se – ndonëse mbahet në vëmendje ekzistenca e marrëdhënies së posaçme prind-fëmijë, në funksion të së cilës mund edhe të kryhen në mirëbesim veprime financiare siç është pretenduar, edhe pse këto të fundit të paformalizuara me një akt konkret, por që në thelb përshkruajnë dinamikën e ngjarjes – trupi gjykues vlerëson se në mungesë të një dokumenti provues apo të një akti të formalizuar ndërmjet palëve, këto pretendime kanë mbetur në nivel deklarativ, për sa kohë nuk janë mbështetur mbi prova konkrete.

50. Lidhur me të ardhurat nga aktiviteti i nënës së subjektit të rivlerësimit – ndonëse provohet ekzistenca e aktivitetit të saj prej vitit 1992 – nga të dhënat e përcjella nga organet tatimore nuk mund të identifikohen qartësisht të dhënat mbi fitime të mundshme të realizuara nga ky aktivitet dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i njoftuar me rezultatet e hetimit për këtë pike nuk ndryshon, për sa kohë të ardhurat e pretenduara nuk janë të provuara as në këndvështrimin e realizimit të tyre dhe as lidhur me pagesën e tatimeve – pra si burim i ligjshëm, në kuptimin të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
51. Gjithashtu, trupi gjykues çmon se pamjaftueshmëria financiare e sipërpërshkruar, së bashku me pasaktësitë e konstatuara më sipër, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe të objektivitetit – për më tepër që këto të ardhura as nuk janë përdorur nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi për blerjen e ndonjë pasurie – nuk konsiderohen të mjaftueshme që të çojnë në marrjen e ndonjë mase ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Genti Dokollari.

6. Lidhur me investimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*

52. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, përveç të tjerash, ka deklaruar se pas dorëzimit të deklaratës *Vetting* ka kryer dy investime në pasuri të luajtshme, përkatësisht: (i) automjet tip “BMW ***”, blerë me kontratën e shitjes me rezervë, datë 15.9.2017, në shumën totale 10,000 euro, me burim krijimi 8,000 euro; dhe (ii) automjet tip “BMW ***”, blerë në gusht të vitit 2019, në shumën totale 25,500 USD, me burim krijimi përkatësisht: (a) 9,000 euro nga shitja e automjetit tip “BMW ***”; (b) 1,521,550 lekë nga kredia bankare dhe *overdraft*-i; si dhe (c) 185,000 lekë nga të ardhurat nga pagat.
53. Lidhur me automjetin tip “BMW ***”, me targa ***, subjekti ka deklaruar fillimisht në DIPP-në e vitit 2017 lidhjen e kontratës së shitblerjes me rezervë, me çmim 10,000 euro, nga i cili ka paguar një kapar në shumën 1,000 euro – shumë kjo e dhuruar nga i ati. Po ashtu, në rubrikën e detyrimeve ka deklaruar edhe detyrimin e mbetur 9,000 euro ndaj shitësit të automjetit, shtetasit E. B..
54. Më pas, në DIPP-në e vitit 2018 subjekti ka deklaruar likuidimin total të çmimit të kontratës së blerjes së automjetit në analizë – me burim krijimi nga pakësimi i pasurisë me shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz ***”, në vlerën 8,000 euro, si dhe pakësimin e gjendjes *cash* nga 70,000 lekë në 35,000 lekë. Gjithashtu, DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 31.12.2020, ka përcjellë dosjen e automjetit tip “BMW ***”, me targa ***, nga ku është konfirmuar kontrata e shitjes me rezervë me nr. ***, datë 15.9.2017, e lidhur

mes palës shitëse E. B.²⁰ dhe palës blerëse Genti Dokollari, kundrejt çmimit total 10,000 euro, në të cilën nuk rezulton të jetë përmendur dhënia e kaparit 1,000 euro. Në vijim, pala shitëse ka nënshkruar një deklaratë noteriale nr. ***, datë 26.6.2018, në të cilën është deklaruar se subjekti i rivlerësimit ka shlyer tërësisht vlerën e plotë të shitjes, në qershor të vitit 2018.

55. Në vijim të hapave hetimorë, Komisioni ka kërkuar informacion mbi çështje të mundshme gjyqësore me palë ndërgjyqëse, shitësin e automjetit E. B. dhe shtetasit e tjerë të përmendur në shkresë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me shkresën nr. *** prot., datë 10.3.2021, ka bërë me dije se në lidhje me shtetasit²¹ e përmendur në këtë shkresë nuk ka rezultuar të ketë ndonjë çështje ku të kenë qenë palë ndërgjyqëse.
56. Subjekti ka deklaruar si burim krijimi për blerjen e automjetit: (i) dhuratë nga babai në shumën 1,000 euro; (ii) të ardhura në shumën 8,000 euro nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”²², si dhe (iii) kursime të subjektit të rivlerësimit në shumën 1,000 euro.
57. Nga shqyrtimi dhe verifikimi llogarive bankare të subjektit nuk ka rezultuar ndonjë transferim të shumës 1,000 euro në favor të këtij të fundit nga babai i tij, si dhe nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion për të provuar dhurimin në fjalë nga babai i subjektit. Ndërkohë, për sa i përket mundësisë së prindërve të subjektit për të kursyer shumën 1,000 euro gjatë vitit 2017, të cilat kanë shërbyer për pagesën e kaparit 1,000 euro, nga verifikimi i llogarive bankare të babait ka rezultuar se në datën 31.7.2017, këtij të fundit i është disbursuar kredia bankare nga “Raiffeisen Bank”, në shumën 696,000 lekë.
58. Nga kjo shumë e përfituar nga kredia e marrë, rezulton se është tërhequr në *cash* deri në datën e nënshkrimit të kontratës së shitjes me rezervë, shuma prej 235,000 lekësh, e cila, edhe pas zbritjes së shpenzimeve jetike për një periudhë prej 1 muaji e gjysmë²³, duken të mjaftueshme për të mbuluar dhurimin e shumës 1,000 euro në favor të subjektit të rivlerësimit.
59. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 28.3.2018, në masën 8,000 euro, me palë blerëse R. K., nga dokumentacioni i disponuar nga Komisioni nuk ka rezultuar kryerja e ndonjë pagese tatimore nga subjekti për të ardhurat/fitimin e realizuar nga shitja, për sa i takon diferencës ndërmjet çmimit të shitjes²⁴ dhe çmimit të blerjes së automjetit në fjalë, në shumën prej 211,840 lekësh. Si pasojë e sa më sipër, trupi gjykues çmon se – referuar përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe duke mbajtur në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit mbi këtë rrethanë – këto të ardhura si fitim i realizuar nga diferenca e çmimit të shitjes, konkretisht shuma prej 211,840 lekësh, në mungesë të pagesës së detyrimeve

²⁰ Shtetasi E. B. rezulton se e ka blerë më parë këtë automjet me anë të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.9.2015, kundrejt çmimit 900,000 lekë.

²¹ Shtetasit Z. O; E. B, E. L. dhe A. B.

²² Pasuri kjo e trajtuar në pikën 3 të këtij vendimi.

²³ Referuar faqes zyrtare të INSTAT-it, nga Anketa e Buxhetit të Familjes për vitin 2017, shpenzimet jetike për një familje me 2 persona kanë qenë në nivelin vjetor prej 476,108 lekësh. Për një periudhë prej 1 muaj e gjysmë këto shpenzime do të rezultonin në shumën 59,513 lekë.

²⁴ Referuar kursit të këmbimit prej 131.48 lekësh në datën e kryerjes së transaksionit, 28.3.2018, rezulton se ekuivalenti i shumës 8,000 euro ka qenë 1,051,840 lekë.

tatimore sipas dispozitave ligjore përkatëse, nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim të ligjshëm.

60. Lidhur me kursimet e subjektit të rivlerësimit – të cituara si një prej burimeve financiare të përdorura për këtë pasuri – nga verifikimi i llogarive ka rezultuar se nga fillimi i vitit 2018 dhe deri në datën 26.6.2018 (kur është nënshkruar deklarata noteriale nga shitësi i automjetit mbi shlyerjen e plotë të çmimit), ka rezultuar se subjekti ka tërhequr *cash* shumën 330,000 lekë. Pas zbritjes së shpenzimeve jetike për një periudhë 6-mujore²⁵, ka rezultuar se subjekti mund të kursente shumën 1,000 euro, të përdorura për këtë pasuri.
61. Nga shqyrtimi dhe analizimi i dokumentacionit të administruar është konstatuar se përveç deklarimit të pagesës së kryer paradhënie në vlerën 1,000 euro, përgjatë hetimit administrativ subjekti ka deklaruar po këto vlerë, likuidimin e plotë më tej, si dhe burimet e përdorura edhe në deklaratat periodike vjetore të viteve 2017 dhe 2018. Në kontratën e shitjes me rezervë pagesa e shumës 1,000 euro si paradhënie e blerjes së automjetit në analizë nuk është përshkruar/parashikuar specifikisht – ndonëse në kontratën e shitjes me rezervë përshkruhet pagesa me këste. Në kontratën e shitjes me rezervë citohej edhe parashikimi se: “[...] çmimi i shitjes do të paguhet nga blerësi me këste brenda datës 20 tetor 2017”, si dhe parashikimi se: “[...] me realizimin e pagesës së kështit të fundit do të lëshohet një deklaratë e shitësit për shuarje detyrimi” – sikurse edhe ka ndodhur.
62. Nga analizimi krahasimor midis përmbajtjes së kontratës së shitjes me rezervë dhe deklarimeve, si dhe dinamikës së veprimeve financiare të kryera ndërmjet tyre apo të pretenduara nga subjekti si të kryera – konkretisht, likuidimi/pagesa e diferencës 9,000 euro është kryer në qershor të vitit 2018 – ka rezultuar një mospërputhje. Ndërkohë, nëse konsiderohet se likuidimi i shumës 9,000 euro është kryer në qershor të vitit 2018 – sipas deklaratës noteriale të lëshuar nga shitësi – nga analiza financiare – duket se për blerjen e këtij automjeti në vitin 2018 subjekti ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën -211,840 lekë.
63. Nga dokumentacioni i përcjellë nga DPSHTRR-ja ka rezultuar se pasuria në fjalë – automjeti tip “BMW ***” – është shitur më pas nga subjekti me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 26.11.2019, shtetasit A. N. (D.), kundrejt çmimit 9,000 euro.
64. Lidhur me këta shtetas, Komisioni i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë²⁶ informacion mbi çështje të mundshme gjyqësore të gjykuara me këto palë ndërgjyqëse. Kjo e fundit, me shkresën e datës 17.3.2021, ka bërë me dije se nga viti 2011 dhe deri më sot nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara me palë ndërgjyqëse ndonjë nga shtetasit për të cilët ishte kërkuar informacion nga Komisioni. Në këto kushte, kjo rrethanë e përjashton ekzistencën e ndonjë konflikti interesash, për sa kohë subjekti është emëruar si gjyqtar në vitin 2015.
65. Pasi janë analizuar dhe vlerësuar të gjitha të dhënat e administruara deri në momentin e mbylljes së hetimit administrativ, subjektit i janë njoftuar rezultatet e mëposhtme:

²⁵ Të cilat, referuar faqes zyrtare të INSTAT-it, nga Anketa e Buxhetit të Familjes për vitin 2018 shpenzimet jetike për frymë kanë qenë në shumën 246,276 lekë.

²⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2021, të Komisionit.

- i. Duket se nuk përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me mënyrën dhe afatet e pagesës së çmimit të shitjes së automjetit tip “BMW ***” me parashikimet në kontratën e shitjes me rezervë, të datës 15.9.2017, situatë kjo që ndërthuret me burimet financiare të përdorura për blerjen e pasurisë në analizë, dhe që për momentin rezultati i mëposhtëm konsiderohet me rezervë.
- ii. Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në shumën -211,840 lekë, për blerjen e automjetit tip “BMW ***”, në vitin 2018.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

66. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e lartpërmendura, ka paraqitur shpjegimet dhe argumentet, ku në mënyrë të përmbledhur është shprehur se: *“[...] Pasi u njoha me analizën dhe konstatimet tuaja, vlerësoj se keni të drejtë. Ju sqaroj se pas tri vitesh përdorimi të makinës ‘CLS ***’ kisha vendosur ta shisja, pasi ishte autoveturë dhe kisha nevojë për makinë të lartë, tip ‘Fuoristradë’, për shkak se gjatë periudhës së dimrit kisha mbetur dy herë në borë në Q.. [...] Një mik i ngushtë i imi më ka thënë se një miku i tij i kishte ofruar një makinë tip ‘BMW ***’ të vitit 2008, për çmimin 10,000 euro, makina nuk ndodhej në Tiranë por në Vlorë dhe nuk kishte dokumentacion, pasi nuk përdorej prej shume kohësh. [...] Gjëja e parë që kam bërë pasi kam marrë makinën ishte pagimi i sigurimit, të cilin e kam prerë në një pikë në Vlorë dhe e kam përdorur derisa bëra edhe verifikimet te koncesionari i BMW-së në Tiranë. [...] Ramë dakord ta blija në çmimin 10,000 euro, vlerë të cilën nuk e disponoja ngaqë nuk e kisha shitur ende makinën time. Meqenëse marrëdhënia ishte mes miqsh, makina kishte rreth një vit që nuk përdorej dhe z. E. B. kishte disa makina të tjera në pronësi, vendosëm që të jepja një kapar për t’i qëndruar fjalës dhe kontrata të lidhej kur të shisja makinën time [...]. Në fund të korrikut, duke qenë se kisha pak lekë kursime dhe ishin pushimet para, kam diskutuar me babain, të cilit i pëlqeu makina, edhe atij i duheshin para ekstra pasi ishte duke kryer studimet Bachelor në Akademinë e Policisë, vendosi të merrte një kredi, prej së cilës më dha shumën 1,000 euro. Këtë shumë ia kam dhënë z. E. B. si kapar dhe kam qenë në pritje të ndonjë blerësi të mundshëm për makinën time. Duke qenë se mund të shitej më shpejt e dërgova makinën në Elbasan tek miku im Z. O., i cili ishte mekanik dhe kishte se ku ta ekspozonte. [...] Duke qenë se ishte paguar 1,000 euro dhe çmimi i plotë do të paguhej pasi të shisja makinën, nuk e kemi specifikuar kaparin, pasi kur t’i paguaja dhe diferencën e mbetur do deklarohet i shlyer çmimi dhe regjistrohej kontrata e shitjes. [...] Pasi ka kaluar afati i pagesës së çmimit, kam diskutuar me z. E. B. dhe më ka thënë: ‘Gent, as mos e vrit mendjen fare, pasi nuk kam nevojë urgjente as për paratë dhe as për makinën, pasi i kam disa në shtëpi’. Duke u mbështetur në këtë bisedë dhe faktin se kontrata varej nga vullneti i tij, kam pritur derisa është shitur makina në prill të vitit 2018 në shumën 8,000 euro. [...] Duke qenë se kisha kursime rreth 90,000 lekë, kam pritur edhe dy muaj deri në qershor që të kurseja dhe të bëja shumën e mbetur prej 9,000 euro, të cilën e kam shlyer pasi kam marrë edhe rrogën e qershorit. Duke qenë se i kisha cash, ashtu ia kam dhënë dhe më pas z. E. B. ka lëshuar deklaratën noteriale. [...] Në lidhje me konsiderimin e shumës prej 211,840 lekësh si e ardhur e ligjshme, pasi është ‘fitimi’ nga shitja e automjetit tip ‘Mercedes-Benz’, i cili*

është blerë 840,000 lekë dhe është shitur 8,000 euro, ose 1,051,840 lekë dhe nuk është paguar tatim fitimi, vlerësoj se kjo shumë nuk mund të përjashtohet dhe duhet konsideruar e ardhur e ligjshme, pasi vërtet automjeti është blerë 840,000 lekë, por siç iu kam shpjeguar që në krye të herës, pas blerjes kam shpenzuar/investuar rreth 200,000 lekë për të dhe ju më keni njohur si shpenzime për automjetin gjatë vitit 2014 në masën 403,081 lekë. Në këtë kontekst, nuk e kam konsideruar ndonjëherë si fitim, por meqenëse ju e vlerësoni se unë kam kursyer në kurriz të shtetit, vullnetarisht për të pasur ndërgjegjen e qetë, kam kryer pranë organeve tatimore pagesën e tatim-fitimit për shumën 211,840 lekë, duke iu vendosur në dispozicion edhe faturën përkatëse. Kjo, jo për të pranuar përgjegjësi, pasi atë e shpjegova më sipër, por për të qenë korrekt në dukje me shtetin, pasi në përmbajtje kam bindjen se nuk kam pasur detyrim të paguaj tatim fitim, pasi nuk kam fituar”.

67. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës:

- i. *screenshot* (pamje të printuara) të diskutimeve të kryera nëpërmjet aplikacionit *WhatsApp*, të noterizuara, në të cilat është diskutuar me ndërmjetësin, për automjetin, çmimin, që automjeti nuk përdorej prej kohësh pasi nuk kishte letra, foto të automjetit, etj.;
- ii. deklaratë noteriale nr. ***, datë 26.4.2021, e shtetasit E. B., në të cilën deklaroi se për shkak të njohjes me subjektin, nëpërmjet një miku të fëmijërisë, pagesa u krye sipas mundësive të blerësit – kjo edhe për faktin se nuk kishte nevojë urgjente për mjete monetare dhe as për automjet tjetër, duke qenë se në atë kohë ka pasur edhe 2 automjete të tjera në përdorim; si dhe
- iii. mandatpagesa e tatimit për fitimin e realizuar nga shitja e automjetit, në datën 26.4.2021.

Vlerësimi i trupit gjykues

68. Lidhur me mospërputhjen e kohës së pagesës së kryer për blerjen e automjetit dhe parashikimeve të kontratës së shitjes me rezervë, trupi gjykues i vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit, pasi nënshkrimi i kontratës së shitjes me rezervë është rezultat i përputhjes së vullnetit të lirë dhe të pavesuar të palëve. Nisur nga parimi i lirisë kontraktore dhe i marrëdhënies së lirë juridiko-civile midis palëve që, ndonëse nuk e kanë formalizuar mund të shtrijnë në kohë nëpërmjet një dakordësie afatet e parashikuara më herët, për sa kohë kanë kontraktuar një shitblerje me rezervë, ku është përshkruar se pagesat do të kryheshin me këste. Gjithashtu, edhe deklarata noteriale e palës shitëse, sikurse edhe deklaramet vjetore të kryera nga subjekti mbi vlerën e dhënë parapagim (por edhe më tej për likuidimin e vlerës së plotë dhe burimet përkatëse edhe në deklaratat e viteve 2017 dhe 2018), konsiderohen si elementë që plotësojnë dhe mbështesin shpjegimet e subjektit, duke i bërë ato bindëse – në mungesë të provës së kundërt.
69. Lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit, të kryera pas rezultateve të hetimit, trupi gjykues, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit – sipas të cilit të ardhurat e realizuara nga subjektet e rivlerësimit, për të cilat nuk janë likuiduar detyrimet tatimore në momentin e realizimit të tyre, nuk mund të konsiderohen të ligjshme - edhe nëse detyrimet tatimore përkatëse do të

paguhen përgjatë procesit të rivlerësimit, pra, pasi është dorëzuar deklarata *Vetting* – çmon se pretendimi i subjektit për të konsideruar si të ligjshme këto të ardhura nuk qëndron dhe mungesa financiare prej 211,840 lekësh – së paku në këndvështrimin formal – mbetet e pandryshuar, ndonëse nuk mund të passjellë pasoja për subjektin për shkak të masës minimale dhe të rrethanave të sipërpërmendura.

70. Lidhur me automjetin tip “BMW ***”, DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 31.12.2020, ka përcjellë dosjen e automjetit, nga e cila ka rezultuar se automjeti në analizë është përfituar me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 3.8.2019, të lidhur ndërmjet palës shitëse, shtetasit A. B.²⁷ dhe palës blerëse subjektit të rivlerësimit, kundrejt çmimit 25,500 USD.
71. Lidhur me burimet e deklaruara që kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti në analizë, me qëllim kryerjen e një hetimi administrativ gjithëpërfshirës, Komisioni ka vlerësuar mundësitë financiare, duke analizuar burimet dhe përllogaritur të ardhurat dhe shpenzimet – ndonëse nga një qëndrim i mëpasëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit²⁸ pasuritë e krijuara pas nisjes së procesit të rivlerësimit, jo detyrimisht mund të jenë objekt rivlerësimi. Vijon shqyrtimi i çdo burimi financiar i përdorur për blerjen e kësaj pasurie:
- i. Kredi bankare dhe *overdraft* në shumën 1,521,550 lekë. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar kontratën e kredisë bankare (e panoterizuar) në datën 19.7.2019, për marrjen e kredisë në shumën 2,000,000 lekë, për arsye personale. Nga lëvizjet e llogarisë bankare të subjektit është konfirmuar disbursimi i kësaj kredie në datën 22.7.2019, në shumën 2,000,000 lekë. Si fillim, nga fondet e kredisë është shlyer kredia ekzistuese në masën 619,621.86 lekë²⁹, e marrë nga subjekti në vitin 2014, gjithashtu është paguar nga subjekti zhdoganimi i automjetit në vlerën totale 461,550 lekë (për llogari të shitësit A. B.), si dhe është kryer pagesa e këstit të parë të automjetit në favor të shitësit, në vlerën 800,200 lekë.
 - ii. Të ardhura nga shitja e automjetit tip “BMW ***”, në shumën 9,000 euro – nga dosja e pasurisë në fjalë, përcjellë nga DPSHTRR-ja, ka rezultuar se automjeti i është shitur nga subjekti i rivlerësimit me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 26.11.2019, shtetasit A. N., kundrejt çmimit 9,000 euro. Nga verifikimi i lëvizjeve bankare ka rezultuar se subjekti ka depozituar *cash*, një ditë pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, në datën 27.11.2019, shumën 1,100,000 lekë. Më pas, ka transferuar në favor të palës shitëse A. B. shumën 1,100,242 lekë, në datën 2.12.2019.
 - iii. Të ardhurat nga pagat e subjektit në shumën 185,000 lekë – pas marrjes së pagës së muajit, më 6.12.2012, së bashku me fondet nga *overdraft*-i është kryer transferimi i këstit të fundit në shumën 400,200 lekë në favor të palës shitëse.

²⁷ Shitësi A. B. është përfaqësuar në këtë kontratë nga shtetasja A. S., me prokurën e posaçme nr. ***, datë 12.3.2019. Nga dosja e automjetit është konstatuar se shtetasi A. B. e ka blerë automjetin në fjalë me faturën nr. ***, datë 12.4.2019, nga pala shitëse “***” SHBA, kundrejt çmimit 19,995 USD.

²⁸ Shihni vendimin nr. 8/2021, paragrafi 26.3 i KPA-së.

²⁹ Së bashku me komisionet, principalin e mbetur dhe interesin.

72. Komisioni, nisur nga analiza e dokumentacionit të sipërpërmendur, të administruar përgjatë hetimit administrativ dhe nga përlllogaritja e burimeve të mundshme financiare, me burime të ligjshme, nuk ka konstatuar problematika lidhur me këtë pasuri, automjet tip “BMW X5”, për sa kohë është deklaruar saktë dhe është krijuar me burime financiare të ligjshme .

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

73. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike të subjektit ndër vite, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, në Aneksin 1, që i bashkëngjitet këtij dokumenti, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
74. Në këtë analizë, janë paraqitur:
- i. pasuritë e realizuara nga subjekti i rivlerësimit, të pasqyruara në vitin përkatës të kryerjes së investimit, me vlerën e përcaktuar në dokumentacionin përkatës të kontratave të shitblerjeve;
 - ii. të gjitha të ardhurat e deklaruara ndër vite dhe të ardhurat e dokumentuara, bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit bashkëngjitur deklaratës *Vetting* dhe/apo në përgjigje të pyetësorëve;
 - iii. shpenzimet jetike janë përlllogaritur në bazë të frymëve sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT-i;
 - iv. shpenzimet e udhëtimit janë përlllogaritur duke u bazuar në raportin e hyrje-daljeve, sipas sistemit *TIMS*, bazuar në vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të KPA-së dhe në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 1;
 - v. shpenzimet e interesave/komisioneve dhe sigurimeve të kredive dhe/apo *overdraft*-it janë konsideruar bazuar në lëvizjet e llogarive bankare të përcjella nga bankat e nivelit të dytë;
 - vi. shpenzimet e sigurimit të automjeteve janë konsideruar sipas policave të sigurimit të vëna në dispozicion nga AMF-ja;
 - vii. shpenzimet për shërbimet të automjetit janë konsideruar bazuar në deklaratimet e subjektit, në përgjigje të pyetësorëve dhe dokumentacionit të paraqitur prej tij;
 - viii. gjendja e likuiditeteve nënkupton gjendjen në fund të çdo viti të ndodhur në të gjitha llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit;
 - ix. detyrimet përfshijnë gjendjen në fund të vitit të të gjitha detyrimeve të subjektit të rivlerësimit ndaj bankave të nivelit të dytë. Në këtë seksion janë shënuar edhe likuidimet e kryera në vijim, të këtyre detyrimeve, me vlerë negative;

- x. kursi i këmbimit i përdorur për të gjitha investimet/shpenzimet/gjendjet bankare në valutë është konsideruar sipas kursit mesatar të fundit të vitit, botuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë³⁰.

75. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat, duke filluar nga viti 2013, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, nga ku ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm pozitiv, siç është detajuar në Aneksin që vijon.

Aneksi nr. 1 - Analiza financiare për periudhën 2013 – 2016

Viti	2013	2014	2015	2016
PASURI	-49,403	1,220,475	-293,308	-54,537
Automjet VW Golf, viti prodhimit 98				
Automjet Mercedes Benz CLS		840,000		
Apartament ne perdorim F***, Tirane				
Ndryshim likuiditeti	-49,403	380,475	-293,308	-54,537
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	-48,756	331,719	38,410	-16,126
DETYRIME	0	1,912,663	-265,785	-290,524
Kredi ne Raiffeisen Bank		1,912,663	-265,785	-290,524
PASURI NETO	-49,403	-692,188	-27,523	235,987
Të ARDHURA dokumentuar	683,987	1,720,257	1,190,169	1,149,374
Te ardhura SR vertetuar	683,987	1,720,257	1,190,169	1,149,374
SHPENZIME	211,129	1,878,486	513,611	614,943
Shpenzime jetese	141,024	219,998	224,276	235,092
Shpenzime interesi/sigurimi te kredise RZB		169,849	122,750	87,455
Shpenzime mobilimi (dhene prinderve nga fondet e kredise)		1,000,000		
Shpenzime udhetimi	70,105	77,003	123,349	224,086
Shpenzime per unionin e gjyqtareve				12,000
Shpenzime interesi te overdraft RZB		8,554	12,056	10,992
Shpenzime sigurimi automjeti			31,180	45,318
Shpenzime servisi per automjetin		403,081		
Analiza dokumentuar	522,261	533,959	704,081	298,444
CASH në Lekë		350,275	137,650	50,000
DIFERENCA E PA MBULUAR		0		

B. KONTROLI I FIGURËS

76. Drejtorja e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë në Komision një raport për subjektin e rivlerësimit me nr. *** prot., datë 31.10.2017, me të cilin është konstatuar përshtatshmëria për vijimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Genti Dokollari. Raporti i sipërcituar është deklasifikuar më 6.1.2021, me vendimin nr. *** të KDZH-së.
77. Përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni dhe në vijim të komunikimeve të mëtejshme me organet ligjzbatuese dhe/ose nga denoncimet e paraqitura nga publiku, nuk

³⁰ www.bankofalbania.org

kanë rezultuar informacione apo fakte të reja për këtë subjekt, që mund të lidhen me kriterin e figurës dhe të mund të ngrinin dyshime mbi konkluzionet e arritura nga Grupi i Punës, në DSIK. Për rrjedhojë, edhe Komisioni e vlerëson të përshtatshëm z. Genti Dokollari për të vijuar detyrën si gjyqtar.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

78. Komisioni, në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka administruar dhe analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur - ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Genti Dokollari, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga KLGJ-ja dhe të përcjellë në Komision; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet dhe organet ligjzbatuese – burime të cilat, kur ka qenë nevoja, i janë nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

C/1. Lidhur me analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLGJ-ja

79. KLGJ-ja ka përcjellë në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 8.1.2021, raportin e përpiluar nga ky institucion për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Genti Dokollari, bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke analizuar të dhënat e rezultuara referuar kriterëve të vlerësimit: (i) aftësitë profesionale; (ii) aftësitë organizative; (iii) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (iv) aftësitë personale dhe angazhimi profesional. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.
80. Sipas këtij raporti: (i) subjekti i rivlerësimit Genti Dokollari ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret; (ii) gjyqtari, përgjithësisht, përdor shprehimisht parimet e përgjithshme të së drejtës si parimi i zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, parimin e disponibilitetit të padisë etj. Përrjashtimisht është evidentuar si e vetmja mangësi shqyrtimi tej afatit ligjor i një kërkesë për sigurim padie në tejkalim të afatit 5-ditor³¹. Për t’u vlerësuar është fakti që të gjitha seancat gjyqësore të vëzhguara dhe që iu përkasin dosjeve 2-5, të gjykuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë janë regjistruar në audio, në funksion të transparencës dhe të solemnitetit të gjykimit. Vetëm në dosjen 1 që është gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk janë të regjistruara në audio seancat gjyqësore.

³¹ Nisur nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni dhe nga shpjegimet e subjektit, edhe ky tejkalim afati vlerësohet i justifikuar për sa kohë ai është shkaktuar nga nevoja për përsëritjen e njoftimeve të palëve.

81. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtari ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore.
82. Arsyetimi ligjor – subjekti i rivlerësimit Genti Dokollari ka aftësi në arsyetimin ligjor me cilësi. Në tri dokumentet e paraqitura nga subjekti dhe në pesë dosjet e vëzhguara ndiqet metoda e ndarjes së vendimit në pjesë. Gjithashtu, në të pesta dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme.
83. Nisur nga sa më sipër, konstatohet se vlerësimi i përgjithshëm i kryer nga KLGJ-ja ka qenë pozitiv, ndonëse janë ngritur dyshime mbi disa problematika të mundshme mbi mosrespektimin e afatit për shqyrtimin gjyqësor dhe vendimmarrjen lidhur me dosjen nr. 2, të përzgjedhur me short, që është trajtuar edhe nga Komisioni – si më poshtë.

C/2. Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

84. Komisioni, në bazë të neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet nga publiku dhe duke analizuar aktet/vendimet/dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.
85. Lidhur me dosjen nr. 2 të përzgjedhur në mënyrë rastësore (me short), që i përket aktit që i referohet vendimit civil nr. ***, datë 3.3.2016, në të cilin subjekti ka vendosur *rrëzimin e padisë, heqjen e masës së sigurimit të padisë*, ku veç të tjerash ka marrë edhe vendimin “Për pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë” me vendimin nr. *** akti, datë 1.2.2016, duke pranuar kërkesën për sigurimin e padisë, urdhërimin e përmbaruesit të pezullojë deri në përfundim të gjykimit ekzekutimin e titullit ekzekutiv për të cilin është lëshuar urdhërekzekutimi³². Vendimi në fjalë është kundërshtuar nga pala paditëse në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila me vendimin nr. ***, datë 13.9.2016, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 3.3.2016”³³.
86. Në drejtim të menaxhimit të kësaj çështjeje janë evidentuar probleme në lidhje me afatin për shqyrtimin e kërkesës së paditëses për sigurimin e padisë, bazuar në paragrafin 1, të nenit 202, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet: “Gjykata, me kërkesë të paditësit, brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë”. Çështja në analizë është regjistruar në datën 23.12.2015, duke planifikuar seancën për shqyrtimin e kërkesës për sigurimin e padisë në datën 29.12.2015, ora 8:20, pra, një ditë tej afatit të parashikuar nga neni 202 i Kodit të Procedurës Civile. Për shkak të ngutshmërisë që

³² Bazuar në Kodin e Procedurës Civile neni 202, sigurimi i padisë lejohej “Me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Sigurimi i padisë lejohej kur: (a) padia mbështetet në prova me shkresë; (b) paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t’i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë. Garancia mund të kërkohet edhe për rastin e parashikuar nga germa “a” e nenit 205, të Kodit të Procedurës Civile “Kërkesa si rregull shqyrtohet në prani të palëve, por në raste të veçanta ose të ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur pala tjetër”.

³³ Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në datën 10.3.2016, pas 7 ditëve nga shpallja, duke respektuar afatin 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

paraqet kërkesa për sigurim padie, njoftimi i palëve me fletëthirrje nuk përfaqëson mënyrën e duhur. Gjithsesi, gjyqtari, edhe në seancën e datës 6.1.2016, duket se ka vepruar pa ngut procedural, pasi, megjithëse ishte e pranishme paditësja, nuk e mori në shqyrtim kërkesën për sigurimin e padisë, por e shtyu seancën për të siguruar njoftimin e të paditurve. Në bazë të paragrafit 2, të nenit 205, të Kodit të Procedurës Civile parashikohet: *“Kërkesa për sigurimin e padisë mund të shqyrtohet edhe kur pala e paditur nuk është e pranishme ose nuk ka dijeni, kjo për shkak të ngutshmërisë së kësaj kërkesë”*.

87. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të disponuar konstatohet se gjyqtari ka marrë vendim për kërkesën për sigurimin e padisë vetëm në seancën e datës 1.2.2016, pas një muaji e 8 ditësh, pra, në shkelje të dukshme të afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 202 i Kodit të Procedurës Civile.
88. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit lidhur me këtë pikë, subjekti i rivlerësimit, veç të tjerash, në mënyrë të përmbledhur ka shpjeguar se: *“[...]Masat organizative dhe veprimet për gjykimin e kësaj çështjeje në tërësi dhe në veçanti kërkesës për marrjen e masës së ‘sigurimit të padisë’ janë sipas dispozitave procedurale civile. Rezulton qartë se në përputhje me ligjin kam vendosur të shqyrtoj masën e sigurimit brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 202 i Kodit të Procedurës Civile. Në datën 24.12.2015 kam marrë dosjen prej sekretares gjyqësore dhe në datën 29.12.2019, kam caktuar seancën përgatitore, duke urdhëruar njoftimin e palëve. [...] Referuar nenit 205 të Kodit të Procedurës Civile (të kohës), parashikohej shprehimisht se: ‘Sigurimi i padisë mund të lejohet për të gjithë padinë ose vetëm për ato pjesë të saj, që gjykata i gjen të bazuara, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 202 të këtij kodi. Kërkesa, si rregull, shqyrtohet në prani të palëve, por në raste të veçanta ose të ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur palët’.. [...] Pasi jam njohur me çështjen e kam vlerësuar të nevojshme thirrjen e palëve, pasi kam konstatuar se nuk paraqiste ndonjë urgjencë për të devijuar nga mënyra e zakonshme e shqyrtimit të saj, që është në prezencë të palëve. Kjo për faktin e thjeshtë se e njëjta çështje ishte pushuar 10 ditë më përpara prej sjelljes së palës paditëse, si dhe rrethanave të çështjes, nuk ka pasur asnjë lloj urgjence apo do të duhej të trajtohej si rast i veçantë”*.
89. Gjithashtu, bashkëngjitur këtyre shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës së re: (i) vendimin e datës 18.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë “Për marrjen e masës së sigurimit të padisë”; dhe (ii) vendimin nr. ***, datë 16.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në të cilin është vendosur: *“Pushimi i gjykimit të çështjes civile. Heqjen e masës së sigurimit të padisë vendosur me vendimin e datës 18.11.2015.”*, si dhe procesverbalet e seancave gjyqësore.

Vlerësimi i trupit gjykues

90. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit e kryesisht ato të dhëna gjatë seancës dëgjimore, kanë rezultuar pjesërisht bindëse – lidhur me nevojën e shtyrjes së seancave për shkak të përsëritjes së njoftimit të palëve – duke vlerësuar dhënien e një rëndësie të veçantë në gjykimin e çështjes dhe aspektit procedural të një gjykimi të drejtë. Ndonëse ka rezultuar se subjekti nuk ka qenë shterues në shpjegimet e veta, lidhur me shkaqet që, sipas tij, e bënin të domosdoshme prezencën e palës së paditur në seancat e

sipërpërmendura, për sa kohë kjo rrethanë do të justifikonte plotësisht qasjen e tij procedurale në raport me dispozitën e nenit 205, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile, që ofronte një mundësi alternative (si më sipëranalizuar) – trupi gjykues çmon se kjo rrethanë nuk rezulton e mjaftueshme për ta cilësuar atë si një mangësi profesionale.

DENONCIME NGA PUBLIKU

91. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur 8 denoncime nga publiku, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të denoncimeve, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore, për të vlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit Genti Dokollari. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur nga publiku pranë këtij institucioni, ka rezultuar se nga përmbajtja e një pjese të tyre nuk janë evidentuar prova mbi shkelje të mundshme të subjektit apo *indicie* mbi të cilat mund të kryhej ndonjë hap hetimor i mëtejshëm nga Komisioni, ndërsa mbi disa të tjerë janë kryer hetime të thelluara dhe janë administruar dokumente e informacione shtesë, disa prej të cilave janë trajtuar në vijim.

1. Denoncimi nr. *** prot., datë 29.1.2019, i shtetasit V. T.

92. Shtetasi V. T. ka denoncuar disa subjekte rivlerësimi dhe ndërmjet tyre edhe gjyqtarin Genti Dokollari, për të cilin është shprehur se në seancën e datës 21.1.2019, ai nuk e ka lejuar të flasë dhe ka treguar mungesë respekti ndaj tij.

Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 3.2.2021, ka vënë në dispozicion vendimin nr. ***, datë 21.9.2019, dhe procesverbalin që i përket çështjes me objekt “kërkesë për dërgimin e çështjes për gjykim” me të pandehur denoncuesin për kryerjen e veprës penale “dhunë në familje”. Nga shqyrtimi i vendimit është evidentuar se denoncuesi V. T. ka qenë i përfaqësuar në gjykim nga një mbrojtës i caktuar kryesisht nga gjykata, ndonëse ka qenë vetë denoncuesi që ka kërkuar gjatë seancës gjyqësore të deklarohej i pafajshëm. Nga analizimi i vendimit dhe i procesverbalit të seancës gjyqësore nuk janë vërtetuar pretendimet e denoncuesit lidhur me shkelje etike të mundshme nga subjekti i rivlerësimit.

2. Denoncimi nr. *** prot., datë 21.1.2019, i shtetasit F. R. H.

93. Denoncuesi F. R. është shprehur se subjekti ka dhënë një vendim të padrejtë pasi nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të nenit 64 të Kodit Penal dhe nuk ka marrë në konsideratë gjendjen e tij familjare në dhënien e vendimit.

Pas kërkesës së Komisionit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka vënë në dispozicion vendimin nr. ***, datë 16.1.2019, ku në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesës për lirim me kusht*”. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me vendimin nr. ***, datë 16.7.2019, ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit penal nr. ***, datë 16.1.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, pranimin e kërkesës së kërkuarit F. H.*”. Gjykata e Apelit Durrës, ndër të tjera, ka konkluduar se nga Gjykata e Shkallës së Parë nuk janë marrë në konsideratë përmbushja njëkohësisht nga i dënuari i kritereve të parashikuara në nenin 64 të Kodit Penal.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

94. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ lidhur me këtë denoncim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në mënyrë të përmbledhur se: “[...] Në vlerësimin tim profesional, pasi u njoha edhe me vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës, është e qartë se: së pari – vlerësimi i faktit apo faktet mbi të cilat mbështeten vendimet nuk janë të njëjta. Gjykata e Apelit konstaton se i dënuari ka pasur sjellje shumë të mirë dhe shembullore pa cituar një provë që e pasqyron këtë fakt, ndërkohë që në vendimin e shkallës së parë janë cituar vlerësimet e sjelljes së IEVP-së Rrogozhinë, ku rezulton një sjellje e mirë në çdo komponent dhe në tërësi një sjellje mëse normale e të dënuarit. Respektimi i rregullores është kërkesë minimale për një të dënuar, pasi në të kundërt i nënshtrohet procedimit disiplinor dhe i dënuari në fjalë përveçse kishte respektuar rregulloren nuk kishte bërë asnjë gjë të veçantë; së dyti – nëse krahasohen të dy vendimet, te vendimi i shkallës së parë çdo komponent i analizës është kriter i elaboruar nga Gjykata e Lartë në vendimin unifikues penal nr. ***, ndërsa në vendimin e Gjykatës së Apelit analiza është abstrakte; së treti – gjykata e shkallës së parë, ashtu si vendimi unifikues, për të analizuar nëse jemi përpara një rasti të veçantë i është referuar rrezikshmërinë së veprës, qëndrimit ndaj saj, gjendjes shëndetësore të të dënuarit, sjelljes së tij referuar dinamikës së IEVP-së, i cili me punën dhe sjelljen e tij duhet të tregojë se është rehabilituar dhe dënimi e ka realizuar qëllimin e tij [...]. Ndërkohë që Gjykata e Apelit në vendimin e saj vlerëson se jemi përpara një rasti të veçantë, pasi i dënuari ka kushte të veçanta familjare, kishte pasur një fatkeqësi familjare etj., duke mos iu referuar vendimit unifikues, i cili siç e thashë me sipër rastin e veçantë e lidh drejtpërdrejt me sjelljen e të dënuarit dhe aspak me elementë që lidhen me faktorë të jashtëm. Sigurisht që këto aspekte janë favorizuese, por nuk janë thelbësore, kjo është ajo që ka unifikuar Gjykata e Lartë në vendimin unifikues penal nr. ***[...]. Së pari, për sa i përket interpretimit teleologjik, orientimi i zgjedhur nga gjykatat më të ulëta që kushtëzon zbatimin e lirit me kusht me praninë e domosdoshme të një kriteri jashtë kontrollit të të dënuarit [...]. Arsyet e veçanta nuk kanë të bëjnë me elementë apo faktorë të jashtëm nga puna dhe sjellja e të dënuarit, por me riedukimin dhe riintegrimin e tij në shoqëri. Vlerësoj se këndvështrimi pozitiv i Gjykatës së Apelit mbi rastin lidhet drejtpërdrejt me faktin se koha e mbetur pa vuajtur në momentin e disponimit ka qenë 4 muaj e 23 ditë, ndërkohë që në momentin e disponimit në shkallë të parë ka qenë 11 muaj e 23 ditë burgim. Koha e kaluar në institucion, sigurisht, që mund të shihet si komponent rehabilitues për sa kohë ligji e lidh pranimin e kërkesës me kalimin e një kohe të caktuar.”
95. Gjithashtu, së bashku me shpjegimin e sipërcituar, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës së re vlerësimin e sjelljes për efekt të kërkesës për “lirim me kusht” të IEVP-së Rrogozhinë për të dënuarin F. H., si dhe raportin mbi të dënuarin të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Vlerësimi i trupit gjykues

96. Duke u bazuar në sa më lart është shpjeguar nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se denoncimi i shtetasit F. R. H., për shkelje procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit Genti Dokollari është i pabazuar, pasi nga shqyrtimi i Komisionit ka rezultuar se janë respektuar dhe garantuar të gjitha të drejtat e të pandehurit, si dhe të mbrojtësit të zgjedhur prej tij në çështjen objekt vlerësimi.

Rrjedhimisht nuk ka rezultuar ndonjë shkelje procedurale ose mosrespektim i të drejtave të palëve, apo arsyetim i dobët dhe/ose i paplotë/munguar, që mund të ishin kryer nga subjekti. Duke mbajtur në konsideratë edhe qëndrimin e KPA-së³⁴, në të cilin orientohet që gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore nuk mund të jetë një alternativë vlerësimi e përdorur prej organeve të rivlerësimit, për sa kohë që ky lidhet me vlerësimin dhe çmimin e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të magjistratit. Nisur nga sa më sipër, në rastin konkret çmohet se përmbajtja e denoncimit nuk është i një natyre procedurale, por lidhet me themelin e çështjes.

3. Denoncimi nr. * prot., datë 15.5.2018, si dhe denoncim/ankesa nr. *** prot., datë 9.4.2019, të shtetasit P. D. (janë shqyrtuar së bashku pasi janë depozituar nga i njëjti denoncues)**

97. Shtetasi P. D. ka pretenduar se gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë dhe subjekti i rivlerësimit Genti Dokollari kanë shfaqur paaftësi profesionale pasi kanë vendosur në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 932, të vitit 2000, të Gjykatës së Lartë dhe me praktikën gjyqësore të llogaritjes së mënyrës së aktekspertimit.

Nga shqyrtimi i vendimit nr. ***, datë 21.3.2018, me objekt “deklarimin e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv dhe pezullimin e vendimit të ekzekutimit”, rezultoi se subjekti në arsyetimin e vendimit është shprehur mbi të gjitha pretendimet e ngritura. Vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila me vendimin nr. ***, datë 2.11.2018, ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit*”. Gjithashtu, denoncuesi ka ngritur pretendime për mënyrën e llogaritjes së vlerës në aktekspertim, për të cilën është shprehur edhe Gjykata e Apelit Korçë se: “*... pretendimet e ngritura lidhur me aktekspertimin dhe metodologjinë e përlllogaritjeve, gjykata ka vlerësuar se ato nuk gjejnë mbështetje në ligj, ajo gjithashtu ka konsideruar të gabuar interpretimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, që i ka bërë llogaritjes së kamatëvonesave tej parashikimit të interesit 12% për dy vjet, për të cilat ka konkluduar se mund të vazhdohet me vjeljen e detyrimit, sipas nenit 470 të Kodit Civil, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me ndryshimin që, shpenzimet gjyqësore duhet të lihen siç janë bërë nga palët*”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

98. Pasi u njoh me rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në mënyrë të përmbledhur se: “[...] Pasi u njoha për sa më sipër, u ndjeva i fyer për sa kohë etiketohem si i paaftë prej një pale në proces, kur procesi gjyqësor i zhvilluar ka qenë model edhe pse shumë i vështirë, pasi palët endeshin me vite prej gjykatave dhe i duhej dhënë fund një herë e mirë mosmarrëveshjeve. Nga vendimi i gjykatës është lehtësisht i konstatueshëm fakti se ekspertit i janë ngarkuar detyrat sipas kërkesave të të dyja palëve, në mënyrë që të kryhej një hetim i plotë dhe i gjithanshëm i çështjes në mënyrë që të mos cenohej procesi nga Gjykata e Apelit dhe, njëkohësisht, detyrat sipas vlerësimit të gjykatës në disa variante, për të mos u ‘parashikuar’ vendimmarrja nga palët dhe ruajtur paanësinë. [...] Pretendimi i ngritur nga ankuesi se kam shkelur kërkesat e vendimit unifikues civil të KBGJL-së nr. 932/200, jo vetëm që nuk qëndron, por edhe i kam dhënë përgjigje në vendim. Kishte

³⁴ Vendimi nr. *** F. V.

vendime të formës së prerë në lidhje me këtë pretendim dhe ishin çështje të gjykuara, prandaj nuk mund t'i nënshtroheshin më gjykimit. [...] Në lidhje me ndryshimin pjesërisht të vendimit prej Gjykatës së Apelit, pasi u njoha me të konstatohet se: së pari, Gjykata e Apelit e vlerëson të gabuar interpretimin që Gjykata e Shkallës së Parë që i ka bërë përlllogaritjes së kamatëvonesave tej parashikimit të interesit 12 % për dy vjet, për të cilat ka konkluduar se mund të vazhdohet me vjeljen e detyrimit, sipas nenit 470 të Kodit Civil. [...] Unë vlerësoj se kam disponuar drejt dhe sipas ligjit, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se kam gabuar. Është në tagrin e saj ta konstatojë diçka të tillë si gjykata më e lartë; dhe së dyti, në lidhje me shpenzimet gjyqësore kam mbajtur parasysh nenin 106 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: 'Taksat mbi aktet, shpenzimet e tjera gjyqësore dhe shpërblimi për një avokat, në qoftë se ka pasur të tillë, të paguara nga paditësi, i ngarkohen të paditurit në masën e pjesës së padisë që është pranuar nga gjykata ...'. Duke qenë se padia u rrëzua, shpenzimet gjyqësore ia kam ngarkuar paditësit. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se pala paditëse nuk i ka dhënë shkas me veprimet e saj ngritjes së padisë, pasi aktet e përmbaruesit kanë qenë të paqarta në lidhje me vlerën totale të detyrimit që duhet të shlyhej ... [...]. Prandaj vlerëson që këto shpenzime mbeten në ngarkim të secilës palë, sikundër janë kryer prej tyre gjatë dy shkallëve të gjykimit. Në lidhje me këtë arsyetim dhe disponim, nuk e di se në cilën bazë ligjore është bazuar vendimmarrja, pasi të vetmin përjashtim që bën ligji nga rregulli vlen për të paditurin, kur ky i fundit nuk i ka dhënë shkas paditësit për ngritjen e padisë dhe padia pranohet, shpenzimet i ngarkohen përsëri paditësit."

Vlerësimi i trupit gjykues

99. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse dhe shteruese lidhur me pretendimet e denoncuesit. Mungesa e shkeljeve procedurale deduktohet edhe nga vlerësimi i bërë nga Gjykata e Apelit Korçë, pasi ky vendim është lënë pjesërisht në fuqi prej saj – ndonëse kjo e fundit ka disponuar një ndryshim vetëm lidhur me shpenzimet gjyqësore. Trupi gjykues vlerëson se ky ndryshim vendimi nuk mund të përbëjë shkak për vlerësimin e kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

4. Denoncimet: nr. * prot., datë 20.10.2020; nr. *** prot., datë 21.2.2020 (ardhur nga KPA-ja); nr. *** prot., datë 12.2.2020; nr. *** prot., datë 10.2.2020; nr. *** prot., datë 6.1.2020 (ardhur nga KPA-ja); nr. *** prot., datë 22.11.2019; nr. *** prot., datë 13.11.2019 (ardhur nga KPA-ja); dhe nr. *** prot., datë 6.11.2019 (ardhur nga KPA-ja) nga shtetasja E. M.**

100. Denoncimi i paraqitur nga shtetasja E. M. për disa subjekte rivlerësimi ndërmjet tyre edhe për gjyqtarin Genti Dokollari akuzon/pretendon për vendimmarrje të padrejtë nga ana e gjyqtarit, pasi ky i fundit ka marrë në konsideratë disa veprime të kundërligjshme të kryera nga përmbaruesi gjyqësor. Në cilësinë e provës, shtetasja ka depozituar vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, të Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe përgjigjen nga Ministria e Drejtësisë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni ka konstatuar se shtetasja E. M. ka ngritur padi me objekt "kundërshtimin e veprimit përmbarimor për pushimin e ekzekutimit të vendimit", me palë paditëse përmbaruesin privat Ç. B., ku në përfundim është vendosur "Rrëzimi i ankimit" me vendimin nr. ***, datë 23.9.2019.

Vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me vendimin nr. ***, datë 9.1.2020, ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë*”. Nga shqyrtimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë konstatohet se denoncuesja ka depozituar rekurs regjistruar nr. ***. Në tërësi të pretendimeve të ngritura dhe të përsëritura shumë herë të denoncueses, por edhe të provave shoqëruese të denoncimit nuk vërehen problematika të natyrës procedurale për veprime të kryera nga subjekti, pasi ato lidhen kryesisht me themelin e çështjes dhe me vendimmarrjen dhe, për pasojë, nuk ka elemente konkrete për hetim dhe vlerësimin profesional lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit.

5. Denoncimi nr. * prot., datë 2.4.2019, i shtetasit N. K.**

101. Shtetasi N. K. ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për vendimmarrje të padrejtë në dhënien e vendimit nr. ***, datë 21.2.2018, duke vendosur “*Rrëzimin e padisë*” së denoncuesit N. K., vendimi i ankimuar në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila me vendimin nr. ***, datë 20.6.2018, ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë*”. Në kushtet kur nga denoncuesi nuk përshkruhen shkelje ligjore konkrete apo procedurale të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 86/2014, Komisioni vlerëson se denoncimi nuk ka *indicie* për thellimin e hetimit.

6. Ankimi nr. * prot., datë 9.9.2019, i shtetasit R. D.**

102. Shtetasi R. D. ka depozituar ankimin lidhur me vendimin e dhënë nr. ***, datë 19.8.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2021, i kërkoi informacion Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë e cila me shkresën nr. *** prot., datë 3.2.2021, ka vënë në dispozicion vendimin nr. ***, datë 2.12.2020, të Gjykatës së Apelit Durrës, e cila ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për “*Kthimin e padisë dhe akteve shoqëruese denoncuesit R. D., me palë të paditur: L. L., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Organizata e Monitoruesve Ndërkombëtar*” me objekt “marrjen e masës së sigurimit të padisë për dosjen gjyqësore”. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka shpjeguar se ka shqyrtuar në cilësinë e gjyqtarit të gatshëm në datën 19.8.2019, çështjen civile: “Paditës: R. D.; të paditur: L. L., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, me objekt: “Shpërblim dëmi. Marrje mase sigurim padie”. Pas shqyrtimit të kërkesëpadisë me vendimin nr. ***, datë 19.8.2019, ka disponuar: “*Kthimin e padisë dhe akteve shoqëruese paditësit R. D.*”. Gjithashtu, ai ka shpjeguar se kërkesëpadia ka qenë totalisht me të meta, vendim ky i cili është konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit Durrës³⁵. Nga shqyrtimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë nuk rezulton të jetë depozituar rekurs. Nga sa më sipër nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit mbi këtë ankim për aq kohë sa nuk përshkruhen shkelje ligjore dhe procedurale nga shtetasi R. D., si dhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë është lënë në fuqi nga një gjykatë me hierarki më të lartë.

7. Denoncimi/ankimi nr. * prot., datë 26.2.2019, i shtetasit S. H.**

³⁵ Subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion vendimin nr. ***, datë 2.12.2020, të Gjykatës së Apelit Durrës.

103. Shtetasja ngre pretendimin se në adresë të saj është dhënë një vendim i padrejtë nga subjekti i rivlerësimit Genti Dokollari, pa prezencën/njoftimin e saj. Nga shqyrtimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin nr. ***, datë 9.11.2018, duke pranuar kërkesën e Prokurorisë Kavajë për dërgimin për gjykim të çështjes penale nr. ***, të vitit 2018, me të pandehur znj. S. H., akuzuar për kryerjen e veprës penale “mashttrim”³⁶. Referuar vendimit të sipërpërmendur ka rezultuar se denoncuesja është përfaqësuar nga av. i saj J* H* me prokurë të përgjithshme, i cili ka vazhduar përfaqësimin e saj edhe më pas. Më tej, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me vendimin nr. ***, datë 28.1.2019, të dhënë nga një tjetër subjekt rivlerësi³⁷ ka vendosur deklarinimin “*fajtor dhe dënimin e saj me 3 muaj burg të denoncueses*”. Nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit, pasi nuk vërtetohen pretendimet lidhur me zhvillimin e procesit në mungesë të shtetasës në fjalë.

8. Denoncimi datë 8.3.2021, i shtetasës E. H.

104. Shtetasja E. H. parashtroi ankesën e saj për zvarritje të procesit gjyqësor nga subjekti i rivlerësimit Genti Dokollari, lidhur me çështjen nr. ***, me datë regjistrimi 27.4.2021, me palë të paditur shtetasin M. B., e cila është ende në shqyrtim. Nga shqyrtimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, rezulton se deri në datën 22.2.2021, janë zhvilluar 5 seanca gjyqësore, ku seanca e datës 21.2.2021, është shtyrë “*për njoftimin e palëve të paditura të kërkesës për shtim të objekti të padisë*”³⁸. Referuar kohëzgjatjes së shqyrtimit të kësaj çështjeje, duket se shqyrtimi/gjykimi i çështjes në fjalë nuk është në respektim të afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

105. Pasi u njoh me rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar në mënyrë të përmbledhur se: “[...] *Pretendimet e shtetasës znj. E. H. janë të pavërteta dhe tërësisht subjektive. Ju sqaroj se kjo padi është depozituar në gjykatë në datën 27.4.2020, që ishte kulmi i pandemisë dhe unë kam shkuar në punë duke disponuar mbi kërkesën e saj për marrjen e masës së sigurimit të padisë në datën 29.4.2020. [...] Veprimtaria e gjykatës ka filluar javën e parë të muajit qershor 2020 dhe janë vënë në lëvizje kryesisht çështjet penale dhe ato civile me afate. [...] Dy javët e para të korrikut 2020 gjykata u karantinua dhe aktiviteti i saj rifilloi rreth datës 20 korrik, duke u gjykuar për 10 ditë vetëm çështjet emergjente penale. Pas pushimeve të muajit gusht, në shtator, pasi kam konstatuar se kishte kaluar afati për paraqitjen e deklaratave të mbrojtjes prej palëve të paditura, kam caktuar seancën përgatitore në datën 20.10.2020, e cila është shtyrë për në datën 11.11.2020, për shkak se i padituri M. B. nuk kishte marrë dijeni dhe F. B. kishte paraqitur raport mjekësor. Seanca e datës 11.11.2020 nuk është zhvilluar për shkak se gjykata është karantinuar për shkak të infektiveve të larta të punonjësve. [...] Seanca e datës*

³⁶ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka vlerësuar se kërkesa e paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë me objekt “dërgimin për gjykim të çështjes penale nr. ***, të vitit 2018 me të pandehur shtetasen S. H., e dyshuar për kryerjen e veprës penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal, i plotëson kushtet e përcaktuara në ligjin procedural penal, referuar neneve 332/a-332/gj të Kodit të Procedurës Penale.

³⁷ Gjyqtare D. G..

³⁸ Kërkesë procedurale bazuar në nenin 185 të Kodit të Procedurës Civile.

11.12.2020 është shtyrë për në datën 12.1.2021, kjo pasi i padituri F. B. kishte paraqitur një sërë dokumentesh shëndetësore gjykata vendosi t'i merrte në konsideratë dhe njoftuar të paditurin, prandaj duhej të merrte masat për të caktuar një përfaqësues, pasi në të kundërt do të vijonte gjykimi në mungesë të tij. [...] Në seancën e ardhshme të datës 22.2.2021 nuk jam paraqitur në punë për arsye shëndetësore të miat dhe familjare. [...] Për këtë kam paraqitur edhe raportin përkatës të paaftësisë në punë. [...] Siç shpjegova edhe në fillim, ankesa është tërësisht subjektive, pasi ankuesja nuk ka marrë në konsideratë qenien në periudhë pandemie; ngarkesën tejet të lartë të gjykatës, e cila ka vetëm tre gjyqtarë, si dhe arsyet procedurale, apo të ligjshme për të cilat janë shtyrë seancat gjyqësore. Sqaroj gjithashtu se paditësja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me të njëjtën padi në vitin 2017 dhe ka zgjedhur ta ringrejë përsëri në prill të vitit 2020, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

106. Subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion si provë të re: (i) urdhrin nr. *** prot., datë 11.11.2020, për miratimin e masave organizative specifike për zhvillimin e proceseve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; (ii) raportin nr. ***, datë 22.2.2021, për paaftësi të përkohshme në punë; si dhe (iii) procesverbalet nr. ***, të seancave gjyqësore të çështjes, me palë paditëse E. H., i paditur M. B. si dhe aktet e dosjes gjyqësore.

Qëndrimi i trupit gjykues

107. Duke mbajtur në vëmendje sa më sipër është analizuar dhe konstatuar nga Komisioni, si dhe duke konsideruar edhe shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e paraqitur prej tij, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit, lidhur me sa më lart ka dhënë shpjegime përgjithësisht shteruese dhe bindëse.

108. Trupi gjykues, në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar dhe të përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit, çmon se shpjegimet e subjektit kanë rezultuar bindëse dhe se në çështjen në analizë nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi etiko-profesionale nga ana e tij.

109. Në këto kushte, në përfundim të vlerësimit profesional, trupi gjykues, pasi ka çmuar faktet dhe rrethanat që lidhen me aktet e shqyrtuara më herët nga KLGJ-ja, si dhe me denoncimet nga publiku, nga një vlerësim i përgjithshëm i kriterit profesional mbërrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Genti Dokollari ka arritur një nivel kualifikues lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, sipas parashikimit të gremës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Genti Dokollari:

1. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
2. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
3. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Në këto kushte, Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit Genti Dokollari, duhet të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe neni 59, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Genti Dokollari, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 30.4.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Relator

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Orjanda Liçi